



SYLLABUS I LËNDËS “ Informatika dhe Krimet Kopjuterike”

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|----------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti juridik |
| Titulli i lëndës: | Informatika dhe Krimet Kopjuterike |
| Programi: | Juridik i përgjithshëm |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | IV/ Semestri VIII |
| Numri i orëve në javë: | 3+2 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 6 |
| Koha / lokacioni: | Fakulteti Juridik |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Enver Buçaj Prof.Asoc.Dr |
| Të dhënat kontaktuese: | enverbuçaj@uni-prizren.com |
| Përshkrimi i lëndës: | <p>Lënda “Informatika dhe Krimi Kompjuterik”, është disiplinë shkencore që merret me studimin e metodave që janë në funksion të parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit kibernetik. Kriminaliteti kibernetik i referohet një spektri të gjerë veprimesh kriminale të ndryshme, ku kompjuterët dhe sistemet informative angazhohen ose si vegël primare ose si shënjestër primare. Krimi kibernetik përfshinë veprat penale tradicionale si: mashtrimi, falsifikimi dhe thyerja e identitetit, veprat në lidhje me përmbajtjen p.sh. shpërndarja në internet e pornografisë së fëmijëve apo nxitja e urrejtjes racore, si dhe veprat që janë unike për kompjuterë dhe sisteme informative. P.sh. sulmet ndaj sistemeve informative, mohimi i shërbimit dhe maluer (malware).</p> |
| Qëllimi i lëndës: | <p>Qëllimi i kësaj lënde mund të përmblihet në objektiva sikurse në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none">- Shpjegimi i standardeve ligjore vendore dhe ndërkombëtare që përcaktojnë politikën e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit kibernetik;- Të kuptuarit e mekanizmave institucional dhe civil që merren me hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve kibernetike; <p>Evidentimi i problematikave dhe sfidave kryesore që paraqet kjo dukuri kriminale në një zhvillim aktual global shumë dinamik.</p> |
| Rezultatet e të nxënit: | Pas përfundimit të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të: |

| | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Të kuptojnë se fenomeni dinamik dhe kompleks i Informatikës dhe krimeve kompjuterike është një nga problemet me aktuale dhe preokupuse për shoqërinë bashkëkohore; - Të formojnë konceptin se këto forma të manifestimit të kësaj dukurie shtron nevojën për thellimin e studimeve rreth njohjes së shkaqeve dhe faktorëve që e kushtëzojnë paraqitjen e këtij fenomeni në shoqëri; - Të njohin bazën juridike për trajtimin dhe parandalimin e krimeve kompjuterike përmes teknologjisë informative, duke i'u qasur analizës së dispozitave juridike pozitive (de lege lata) dhe duke marrë parasysh nevojën për plotësimin dhe ndryshimin e infrastrukturës ligjore nga kjo fushë (de lege ferenda); - Të pajisen me aftësi të mjaftueshme për të identifikuar natyrën dhe karakteristikat e krimeve kompjuterike në shoqëri. E tërë kjo bëhet me qëllim që në vendet e tyre të punës në të ardhmen të jenë të përgatitur që të reagojnë me sukses dhe profesionalizëm ndaj kësaj dukurie të dëmshme për shoqërinë. |
|--|--|

Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
|--|----------|-----------|----------|
| Ligjërata | 3 | 15 javë | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 javë | 30 |
| Punë praktike | 2 | 2 | 2 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 0.30 min | 14 | 7 |
| Ushtrime në terren | 0 | 0 | 0 |
| Kollokfiume, seminare | 2 | 2 | 2 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 2 | 2 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 15 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final) | 1 | 1 | 1 |
| Projektet, prezantimet ,etj | 1 | 1 | 1 |

| Totali | | 150 orë (7 ECTS) |
|--|---|------------------|
| <p>Metodologjia e mësimdhënies:</p> | <p>Gjatë shtjellimit dhe ligjërimit të problemeve të Informatikës dhe krimeve kompjuterike do të përdoren disa metoda të cilat janë më të përshtatshme për ofrimin e materies studentëve dhe aftësimin e tyre që ti kuptojnë nocionet dhe përmbajtjet kryesore.</p> <p>Kësisoj do të aplikohet metoda e mësimdhënies aktive dhe inter aktive që do të thotë eksplorimi dhe interpretimi i çështjeve fundametale të kësaj lënde duke u ofruar studentëve shpjegime, të dhëna e informacione esenciale dhe aktuale mbi dukuritë e informatikës dhe krimeve kompjuterike dhe shkaqet e tyre. Njëherit kjo metodë nënkupton edhe kyçjen aktive të studentëve në debate dhe trajtime të çështjeve që konsiderohen me interes të veçantë.</p> <p>Po ashtu, do të përdoret edhe metoda e studimit të rasteve të krimeve kompjuterike përmes teknologjisë informatike, metodat e interpretimit të dispozitave ligjore pozitive, metoda e analizës së lëndëve gjyqësore ose të rasteve të prezantuara në masmedia apo raporte të organizatave qeveritare ose joqeveritare mbi dukuritë aktuale të kësaj dukurie në botë apo në rajon.</p> <p>Në trajtimin dhe shpjegimin e problemeve të tilla do të përdorim edhe metoda dhe teknika tjera të mësimdhënies të cilat janë më adekuate dhe më të favorshme për përmbajtjet konkrete. Kësisoj veçmas do të organizohen debate, do të aplikohen teste, kollokfiume, ese dhe seminare të cilat do t'i nxisin studentët që në mënyrë aktive dhe me vetiniciativë të kyçen në procesin mësimor, në nxënien dhe avancimin e materies së kësaj lënde mësimore. Si formë e angazhimit shtesë do të përgatitet edhe një projekt hulumtues me studentë nga problematika e krimeve kompjuterike përmes teknologjisë informatike.</p> | |
| <p>Metodologjia e vlerësimit:</p> | <p>Kritere për vlerësimin e punës dhe dijes së studentëve do të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vijimi me rregull i ligjëratave dhe ushtrimeve; - Pjesëmarrja në debate dhe diskutime në klasë; - Hartimi dhe prezantimi i temave për debate; - Përgatitja dhe prezantimi i punimeve seminarike; - Rezultati i dijes në kollokfiume; - Rezultati i dijes në provim. | |

Literatura

Literatura primare:

- Enver Buçaj, “Terrorizmi Kompjuterik”, Prishtinë, 2015
- Veton G. Vula, “Kriminaliteti Kompjuterik”, Prishtinë, 2010
- Copmputer Crime, Investigation, and dhe Law by Chuck Easttom and Det. Jeff Taylor;
- Terrorizmi. Dr. Haki Demolli, 2002;
- Kriminalistika. Dr. Vesel Latifi, 2009;
- Kriminologjia . Dr. Ragip Halili, 2008;
- Kibernetika dhe hyrje ne informatike, Dr. Muhamet Mustafa;
- Ligji nr. 03/L-166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik;
- Ligji nr. 04/L-145 për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit;
- Ligji nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike;
- Ligji nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike;
- Ligji nr. 05/L-030 për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike;
- Ligji nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligji nr. 04/L-065 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;
- Ligji nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë
- Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale;
- Kodi nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur;
- Direktiva 2013/40/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 12 gusht 2013, “Për sulmet kundër sistemeve të informacionit”.

| | |
|---------------------------|---|
| Literatura shtesë: | <ul style="list-style-type: none"> - Kushtetuta e Republikës së Kosovës; - Ligji nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës; - Ligji nr. 04/L-076 për Policinë; - Ligji nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike; - Ligji nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë; - Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; - Ligji nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare; - Ligji nr. 04/L-213 për Ndhmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale; - Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare; - Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror; - Ligji nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare; - Ligji nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë; - Ligji nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike; - Ligji nr. 04/L –004 për Shërbimet Private të Sigurisë. - Agjencia e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, Këshilli i Evropës, Manual i së drejtës evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave, 2014; - OSCE, Doracak për krimin kompjuterik, 2014. |
|---------------------------|---|

| Plani i dizajnuar i mësimi: | | |
|------------------------------------|---|-----------------|
| Java | Ligjërata | Ushtrime |
| <i>Java e parë:</i> | Kuptimi dhe lënda e “Informatikës dhe krimeve kompjuterike” | |
| <i>Java e dytë:</i> | Disa aspekte të trajtimit të krimeve kompjuterike përmes teknologjisë informative | |
| <i>Java e tretë:</i> | Elementet përbërëse të kriminalitetit kompjuterik dhe terrorizmi kompjuterik. | |

| | | |
|------------------------------|--|--|
| <i>Java e katërt:</i> | Rregullativa ligjore për krimet kompjuterike. | |
| <i>Java e pestë:</i> | Aktet ndërkombëtare dhe parandalimi i krimeve kompjuterike; viktimat dhe format me të shpeshta të viktimizimit nga krimet kompjuterike. | |
| <i>Java e gjashtë:</i> | Format dhe karakteristikat themelore të manifestimit të krimeve kompjuterike. | |
| <i>Java e shtatë:</i> | Veçoritë, dinamika dhe struktura e kriminalitetit kompjuterik. | |
| <i>Java e tetë:</i> | Kollëkfium I ora e paë Orët tjera ligjeratë: Faktorët objektiv dhe subjektiv të informatikës dhe kriminalitetit kompjuterik. | |
| <i>Java e nëntë:</i> | Ballkani dhe lufta e krimit kompjuterik. | |
| <i>Java e dhjetë:</i> | Parandalimi dhe luftimi i kriminalitetit kompjuterik. | |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | Bashkëpunimi ndërkombëtarë për parandalimin dhe luftimin e krimeve kompjuterike. | |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | Aspektet ndërkombëtare mbi Informatikën dhe kriminalitetin kompjuterik. | |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | Etika kompjuterike dhe arsimimi. | |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i> | Disa karakteristika mbi të ardhmen e Informatikës dhe Kriminalitetit kompjuterik Vetëdijesimi i qytetarëve për rëndësinë e Informatikës dhe rrezikun nga krimet kompjuterike, terrorizmi kompjuterik si masë parandaluese. | |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | Kollëkfium II | |

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar:

- Studenti duhet të respektojë orarin e ligjëratave dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Ti përmbahet të gjitha rregullave edukativo-arsimore;
- Studenti duhet të jetë i përgatitur për ligjërata duke qenë të pajisur me librin përkatës dhe fletoren për shënime;
- Në respekt të kolegëve të tyre studentë, ata duhet t'i ndalojnë telefonat personal gjatë mësimit; n Studenti duhet të jetë pjesëmarrës aktiv në ligjërata; n Studenti



është i obliguar të paraqesë dhe posedoj ID kartelën në kollokfiume dhe në testin përfundimtar.

Shënim

Pjesëmarrja është parakusht për studentët që dëshirojnë të fitojnë njohuri të duhur të këtij kursi. Studentët që ndjekin rregullisht kursin do të jetë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë aktive në klasë, duke dhënë kontributin e tyre konkret gjatë ligjëratave interaktive dhe gjatë ushtrimeve. Prandaj, kontributi i tyre për pjesëmarrje dhe të mësuarit dhe detyrat e tyre do të vlerësohen gjatë gjithë semestrit, në përqindje në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht.